

# “Indekset e transparencës proaktive”, Zyra e Komisionerit realizon vlerësimin vjetor të autoriteteve publike

Për të pestin vit me radhë, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikon dy dokumente të rëndësishme në funksion të procesit monitorues të autoriteteve publike, përkatësisht “Indeksin e transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë” dhe “Indeksin e transparencës proaktive të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se autoritetet publike kanë hyrë në një fazë të re me një qasje më serioze dhe më sistematike në përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit. Për hartimin e “Indekseve” është zbatuar një metodologji bazuar në matjen e 12 treguesve, nëpërmjet të cilëve është vlerësuar niveli funksional dhe objektiv i transparencës proaktive për 355 autoritete publike të pavarura, qendrore dhe të varësisë, të sistemit të drejtësisë, bashki e këshilla qarqesh, etj.

Përditësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i Programit të Transparencës vendos në një nivel tjetër marrëdhënien e institucioneve me qytetarët apo grupet e interesit dhe përbën formën parësore të komunikimit dhe njohjes me veprimtarinë e tyre.



Duke marrë në konsideratë volumin e informacionit/dokumentacionit me karakter publik që duhet publikuar, Zyra e Komisionerit ka nxitur gjithnjë mënyrat më praktike dhe të shpejta të dhënies së tij. Në këtë kontekst, një Program Transparence i plotë krijon premisën fillestare për besimin e qytetarit në veprimtarinë e autoritetit publik.

Ky ushtrim i përvitshëm tregon edhe një herë se roli monitorues dhe mbikëqyrës i Zyrës së Komisionerit për konsolidimin e transparencës proaktive ka sjellë rezultate konkrete. Të dhënat e “Indekseve” edhe pse inkurajuese, megjithatë, duhet të vlerësohen me sy kritik në radhë të parë nga autoritetet publike, duke qënë se ka mundësi reale që transparenca proaktive të konsiderohet si themelore në punën e tyre. Në këtë mënyrë bashkëveprimi me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile por edhe median do të sillte forcimin e kulturës së hapjes, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, përkundëjt mentalitetit të vjetëruar të hermetizmit të administratës publike.

- [1. Indeksi i transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë](#)
- [2. Indeksi i transparencës proaktive të njësisve të vetëqeverisjes vendore](#)



# Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit shkurt 2025 ka dhënë një vendim në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Sipas [Vendimit nr. 1, datë 07.02.2025](#), Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj "Bordi i Mbikëqyrjes Publike" (në vijim "Autoriteti Publik" ose "BMP"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Ankuesi, nëpërmjet kërkesës depozituar pranë Autoritetit Publik, ka kërkuar t'i vendosen në dispozicion dokumentacioni, në lidhje me: "buxhetin total të harxhuar nga BMP për periudhën 2017-2023; listën e plotë të anëtarëve të BMP për vitin 2017-2023, si dhe për periudhën 1 janar 2024-13 dhjetor 2024; listën e plotë të anëtarëve të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP) për periudhën 2017-2023, si dhe për periudhën 1 janar 2024-13 dhjetor 2024; listën e plotë të anëtarëve të Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës (KIDB) në vitin 2017, si dhe për periudhën 1 janar 2024-13 dhjetor 2024 dhe listën e plotë të anëtarëve të Komisionit Ligjor për vitin 2017-2023, si dhe për periudhën 1 janar 2024-13 dhjetor 2024".

Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me pikën e parë dhe të dytë të kërkesës, duke refuzuar dhënien e informacionit në lidhje me pikën e tretë, të katërt dhe të pestë të saj. Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje të plotë nga Autoriteti Publik, ankuesi, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë dhe pas shqyrtimit paraprak të praktikës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ajo përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të LDI.

Në ndjekje të procedurës, Zyra e Komisionerit i kërkoi Autoritetit Publik qëndrimin në lidhje me ankesën dhe në përgjigjen e këtij të fundit sqarohet se: "BMP financohet nëpërmjet Buxhetit të Shtetit", sipas ligjit nr. 10091/2009, nuk ka marrë asnjë financim nga buxheti i shtetit dhe ushtron veprimtarinë e tij funksionale me vetëfinansim të plotë. Palës ankimese i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni i kërkuar duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si edhe ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Të dhënat e anëtarëve të komisioneve të ngritura pranë BMP, mund të përdoren vetëm për qëllime ligjore të cilat kanë lidhje me objektin e aktivitetit të Bordit dhe detyrën funksionale të anëtarit të komisionit".

Pas kësaj përgjigje, ankuesi ka kërkuar vijimin e ankimit. Në përputhje me procedurën administrative, u vendos kryerja e inspektimit pranë Autoritetit Publik, ku grupi i inspektimit kontaktoi me përfaqësuesen e tij, së cilës i ishte kaluar për trajtim kërkesa për informacion. Në këtë inspektim u kërkua informacion nëse dokumentacioni i kërkuar disponohet nga Autoriteti Publik, si dhe për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi. Përfaqësuesja e Autoritetit Publik sqaroi se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar disponohet nga ky i fundit, si dhe rikonfirmoi qëndrimin si më sipër trajtuar, duke refuzuar vendosjen në dispozicion të tij.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ,

Zyra e Komisionerit konstatoi se, Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin lidhur me pikën 1 dhe 2 të kërkesës fillestare. Ndërsa për pikat 3, 4 dhe 5 të saj, BMP është shprehur se, informacioni i kërkuar nga ankuesi nuk përfshihet në kategorinë e "informacionit publik".

Gjithashtu, BMP argumenton se, informacioni lidhur me anëtarët e komisioneve të ngritura pranë tij konsiderohet si informacion i brendshëm. Ndërkohë, krahas kufizimeve ligjore të cituara, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion listën e anëtarëve të KPAP, emrat të cilëve janë të publikuar në faqen zyrtare të BMP, por nuk ka vendosur në dispozicion listën e emrave të anëtarëve të tjerë të këtij komisioni (periudha 2017-2020), si dhe listëne anëtarëve të komisioneve të tjera të BMP.

Komisioneri vlerëson se, ky qëndrim i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është as në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, as me ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, i zbatueshëm në kohën e depozitimit të kërkesës fillestare për informacion. Ky qëndrim përforcohet edhe nga parashikimet e ligjit të ri nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe përkufizimin e termit "zyrtar" sipas ligjit nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar. Njëkohësisht, publikimi i këtij informacioni parashikohet edhe në Rregulloren nr. 2, datë 22.02.2018 "Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe Mbikëqyrjes së Procesit të Testimit të Kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike", e ndryshuar.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit në tërësi të provave nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, rezultoi e vërtetuar përgjegjësia për refuzimin e dhënies së informacionit, duke mos përmbushur detyrimin për kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion. Lidhur me këtë konstatim, nga ana e nëpunësit nuk u paraqit asnjë pretendim, vërtetuar kjo nga procesverbali i mbajtur pranë Autoritetit Publik.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, specifikisht në çështjen "Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë". E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në përfundim Komisioneri vendosi pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar për pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës fillestare, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI. Njëkohësisht, Komisioneri vendosi dënimin e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të LDI.

# Të dhënat e hapura, Komisioneri Dervishi: “Rrisin transparencën dhe mirëqeverisjen, sjellin zhvillim dhe inovacion”

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me projektin e Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Mirë organizuan tryezën e diskutimit me organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike “Kuptimi dhe zbatimi i ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik”. Komisioneri, z. Besnik Dervishi në fjalën e mbajtur u ndal te rëndësia jo vetëm e ruajtjes së të dhënave publike, por edhe administrimit dhe publikimit të tyre, në portalin e integruar [opendata.gov.al](http://opendata.gov.al), si një mjet për më shumë transparencë dhe llogaridhënie të autoriteteve dhe sipërmarrjeve publike.

“Sasia e të dhënave publike në vendin tonë, është rritur dukshëm. Kur të dhëna të tilla janë të hapura për ripërdorim, i shërbejnë jo vetëm rritjes së transparencës, mirëqeverisjes, përgjegjshmërisë së administratës, kërkimit shkencor, por edhe zhvillimit të ekonomisë mbi zgjidhje inovatore. Operatorët e sektorit publik, edhe për shkak ndoshta të një kulture disavjeçare, janë mësuar të mbajnë të dhënat e tyre brenda institucionit, ndikuar edhe nga rreziku se të dhënat që ata do të ndajnë mund të keqpërdoren ose keqinterpretohen. Ata mund të jenë të shqetësuar se publikimi i të dhënave i bën vulnerabël ndaj kritikave të mundshme. Megjithatë, përfitimet i tejkalojnë këto rreziqe dhe tashmë hapja e të dhëna është e detyrueshme me ligj” - theksoi Komisioneri.



Z. Dervishi vuri në dukje, gjithashtu, se zbatimi i këtij ligji kërkon bashkëpunim nga ana e të gjitha institucioneve publike të përfshira, si edhe ekspertizën e domosdoshme të Bashkimit Evropian, për të sjellë përfitime për të gjithë, jo vetëm për publikun dhe qytetarët, por edhe vetë organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike.

Përfaqësues të projektit të BE për Qeverisjen e Mirë vlerësuan pozitivisht miratimin e ligjit të ri për të dhënat e hapura nga Shqipëria, të përafuar në masë të gjerë me direktivat komunitare. Ata vunë në dukje se tani me rëndësi do të jetë zbatimi i ligjit, duke rritur aksesin të të dhënave të disponueshme nga autoritetet publike, si edhe ndërgjegjësimin e përdoruesve. Ata shprehën, gjithashtu, angazhimin për të vijuar mbështetjen për Zyrën e Komisionerit përmes projekteve të asistencës.

Ligji për të dhënat e hapura parashikon krijimin dhe funksionimin e një portali qendror [opendata.gov.al](http://opendata.gov.al), për të bashkuar katalogët e të dhënave të hapura të publikuara nga operatorët e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike. Ai është krijuar për ta bërë sa më të thjeshtë të jetë e mundur që të gjithë të kenë akses, të kuptojnë, të kombinojnë dhe të përfitojnë nga të dhënat e hapura, pra për të ndihmuar organizatat dhe individët të maksimizojnë vlerën e tyre. Grupet e prekura nga fushëveprimi i këtij ligji janë organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike, biznesi, shoqëria civile, qytetarët, e grupe të ndryshme palësh të interesuara.

Kompanitë dhe bizneset e reja, në veçanti, do të përfitojnë akses më të lehtë në një gamë më të gjerë të të dhënave të sektorit publik, konsumatorët dhe qytetarët përfitojnë po ashtu nga zbatimi i këtij ligji, pasi do të kenë një zgjedhje më të gjerë të produkteve digjitale më të mira dhe të lira, të zhvilluara në bazë të të dhënave të sektorit publik. Edhe vetë organet e sektorit publik do të kenë përfitime nga zbatimi i ligjit në aksesimin më të lehtë të të dhënave të njëri-tjetrit.

# Ekspertët e BE zhvillojnë trajnim me Zyrën e Komisionerit mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik



Me mbështetjen e ekspertëve të projektit të Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Mirë, Zyra e Komisionerit zhvilloi një trajnim për trajnerët (ToT), mbi zbatimin efektiv të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Në këtë tryezë, stafi Zyrës së Komisionerit përfitoi njohuri të zgjeruara mbi të dhënat e hapura dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe diskutoi më ekspertët ndërkombëtarë mbi diferencën e të dhënave të hapura dhe të drejtës për informim. Një çështje tjetër që u përfshi në trajnim ishte mbikëqyrja e Zyrës së Komisionerit për zbatimin e ligjit nr. 33/2022 nga ana e autoriteteve apo sipërmarrjeve publike.

Eksperti i projektit, z. Zoran Jachev, shprehu vlerësimet e tij për autoritetin për angazhimin dhe përkushtimin e treguar në funksion të zbatimit të këtij ligji. Ndërsa Drejtorja e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, znj. Elona Hoxhaj, theksoi se Zyra e Komisionerit ka bërë përpjekje dhe hapa konkrete në ndërgjegjësimin e organeve publike, duke kontaktuar 220 autoritete publike gjatë viti 2024, më qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e tyre.

Ky trajnim u realizua si pjesë e Komponentit të 4-t të projektit “Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë”, pjesë e të cilit është edhe realizimi i manualit informues për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e tyre.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:

